



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

Tiranë me 06.03 .2020

**Njoftim mbi përfundimin e procedurës “Lëvizje paralele”
dhe zhvillimin e procedurës: “Pranim në shërbimin gjyqësor”, për pozicionin
“Specialist/e, në Sektorin e Regjistrimit”.**

Në zbatim të nenit 56, të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 22, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II-të, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentave personale (05.03.2020), të kandidatëve për konkurrim, me procedurën e lëvizjes paralele, asnjë kandidat nuk ka paraqitur dokumentat për konkurrim, për vendin e lirë të punës “**Specialist/e, në Sektorin e Regjistrimit**”.

Njësia përgjegjëse pranë Gjykatës së Lartë (Sektori i Personelit dhe Shërbimeve) njofton se për vendin vakant “**Specialist/e, në Sektorin e Regjistrimit**”, do të vazhdohet me procedurën: “**Pranim në shërbimin gjyqësor**”.

Kandidatët do të paraqesin dokumentat me procedurën e pranimit në shërbimin gjyqësor, deri me datën **10.03.2020** dhe do të marrin informacion në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, duke filluar nga data **20.03.2020**.

NJËSIA PËRGJEGJËSE

SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

